

1998, Shpëtimi dhe disa mjekë të tjerë u inkuadruan në ekipet e mjekëve, të cilat KNKK-ja i kishte organizuar për tu dhënë ndihmë shëndetësore civilëve që ishin të rrezikuar nga ofensivat e forcave serbe. Ka qenë në lidhje të vazhdueshme me komandantët e UÇK-së në *Drenicë/Drenica*. Në fund të shtatorit të vitit 1998, Shpëtimi dhe mjekë të tjerë nga ekipi i KNKK-së kanë tentuar për tri ditë rresht të depërtonin nëpërmjet rrugëve dytësore deri te bjeshka e *Çiçavicës/Çiçavica*, ku kishte shumë njerëz të plagosur. Në datën **30.09.1998**, u nisën nga ora 9:00 nga Prishtina/Priština me dy makina. Arritën vetëm deri te Obria e Epërme/Gornje Obrinje. Atje, banorët u thanë se të plagosurit gjenden në Abrinë e Ulët/Donje Obrinje. U këshilluan që të niseshin rrugës nëpërmjet fshatit të Likocit/Likovac. Në hyrje të **Likocit/Likovac**, u lindi dyshimi se rruga ishte e minuar dhe e kthyer makinat mbrapa. Por, makina në të cilën gjendeshin Shpëtimi, doktor Ilir Tolaj, nëpunësja e KNKK-së Margaret Briston dhe përkthyesja Linda Bunjaku, ka rënë në minë. Nga shpërthimi, Shpëtimi ka marr lëndime të brendshme, ndërkaq bashkudhëtarët e tij ishin lënduar vetëm lehtë. Ka ndërruar jetë nga ora 13:30. E kanë varrosur më 2.10.1998 në varrezat e Prishtinës/Priština.

**Burimet:** deklarata I.T, FDH-36483; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 229, 913; fotografi, FDH-18553; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHF DUÇK, *Feniksët...8*, 273-276; *Mine Explodes, Albanian Doctor Dies*, pasqyra e lajmeve, KIC, 30.09.1998, FDH-33992.

## Rizah (Zenë) Berisha

(13.06.1934, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac, bujk, tre fëmijë)

Rizahu me bashkëshorten e parë Nurijen i kishin dy djem – Xhavitin dhe Hajdinin. Nuriya ka ndërruar jetë shumë herët dhe, më pas, Rizahu u martua me Radmilen, me të cilën e ka patur djalin Abedinin. Në shtëpinë familjare në Shtuticë/Štutica jetonin Rizahu, Radmila [pas martesës, e ka

ndërruar emrin në Raba], Hajdini dhe Abedini, ndërkaq Xhaviti me familje jetonin në Gjermani. Jetonin në varfëri. Nga mesi i vitit 1998, Hajdini u zhvendos në fshatin e lindjes së shoqes. Përderisa në datën e pacaktuar e muajit **tetor të vitit 1998**, në rrugët e Glogocit/Glogovac shiste cigare, Abedinit iu afruan persona të panjohur, e morën dhe e çuan në shtabin e UÇK-së në Prelloc/Prelovac. I bënin pyetje për të atin, interesohesh nëse në shtëpi kishte armë duke e keqtrajtuar fizikisht. Pas dy orësh, e futën në bagazhin e makinës dhe e kthyen në shtëpi. Më pas, nga shtëpia e morën Rizahun dhe e çuan në drejtim të panjohur. Pas disa ditësh, një i afërm i ka thënë Abedinit se e kishte vërejtur Rizahun në **Qirez/Ćirez** në përcjellje të ushtarëve të UÇK-së. Pas luftime, Abedini dhe Raba u përzunë nga shtëpia për shkak të origjinës së saj. Abedini e ka paraqitur zhdurjen e të atit vetëm pas disa vitesh. Emri i Rizahut gjendet në regjistrin e personave të zhdukur të KNKK-së dhe lënda e tij e mban numrin BLG-804829-01.

**Burimet:** deklarata A.B, FDH-37802; deklarata A.B, FDH-37803; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Dragiša (Svetozar) Lukić

(1.01.1976, serb nga Dresniku/Drnsnik, komuna e Klinës/Klina, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dragiša ka qenë pjesëtar i forcave shtesë të MPB-së së Serbisë nga viti 1998. Në datën **7.10.1998**, rreth orës 15:00, ka qenë në detyrë në postbllokun policor në **Aqarevë/Ovčarevo**, kur pjesëtarë të UÇK-së kanë hapur zjarr ndaj postbllokut. Dragiša e ka humbur jetën në këtë sulm.

**Burimet:** SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 38; KMKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 534, 941; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini*, <http://www.srbija-info.yu/ve-sti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

## Zymer (Halim) Goxhuli

(10.01.1965, shqiptar nga Makërmali/Makrmal, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)